




Platforma Regionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të
Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve
Western Balkans Regional Platform for Advocating
Media Freedom and Journalists' Safety



This project is funded by
The European Union

Treguesit për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [KOSOVA 2017]



**Treguesit për nivelin
e lirisë së mediave
dhe sigurisë
së gazetareve
[KOSOVA 2017]**

Autor: Petrit Çollaku
Nëntor 2017

Titulli origjinal

Treguesit e Kosovës për nivelin e lirisë së mediave
dhe sigurisë së gazetarëve (Kosovo)

Botuesi

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Autor

Petrit Çollaku

Redaktor

Natyra Avdiu

Visar Sutaj

Lektor

Florian Agalli


Dizajni

One Solution



“Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian.
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit të Gazetarëve të
Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet që reflekton pozicionin e
Bashkimit Europian.”

Përmbledhja ekzekutive	7		
Treguesit A.	11		
Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve			
A.1	11	B.3	25
A siguron legjislati kombëtar garanci për lirinë e mediave dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?		Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?	
A.2	16	B.4	26
A shkakton ligji i shpifjes një efekt 'trishtues mes gazetarëve'?		Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?	
A.3	17	B.5	26
A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatave zgjedhore?		Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?	
A.4	18	C.	29
A është liria e punës dhe asociimit të gazetarëve e garantuar dhe e zbatuar në praktikë?		Siguria e gazetarëve	
A.5	20	C.1	29
Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?		Statistikat e sigurisë dhe pandëshkueshmërisë	
A.6	20	C.2	31
Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?		A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?	
B.	23	C.3	32
Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës		A i trajton me efektivitet sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?	
B.1	23	Shtojca	35
A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?		Referenca dhe burime	37
B.2	25	Dokumente ligjore, politika	38
Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e mediave dhe strukturat udhëheqëse?		Artikuj të medieve	38



Përmbledhja ekzekutive

Ky raport paraqet të gjeturat e hulumtimit të dytë të zhvilluar përbrenda projektit rajonal Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për avokim të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, të zbatuar nga asociacionet e gazetarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi.

Ky raport është vijueshmëri e studimit bazë, i cili ka paraqitur në mënyrë më të gjerë situatën e legjislacionit dhe çështjet socio-ekonomike dhe politike në lidhje me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve dhe ka identifikuar sfidat kryesore dhe rekomandimet për asociacionet e gazetarëve dhe hisedarë të tjerë.

Qëllimi kryesor i këtij studimi kërkimor është zbulimi i zhvillimeve të reja dhe krahasimi me nivelet e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve që janë identifikuar në vitin 2016.

Ky studim kërkimor është kryer nga Petrit Çollaku në bazë të metodologjisë së përbashkët për të gjitha pesë shtetet. Metodatat në vijim janë zbatuar për mbledhjen dhe analizën e të dhënave:

- Analiza cilësore e dokumenteve (ACD) e studimeve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademikë, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe e mbulimit mediatic (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).
- Intervistat cilësore me 8 individë (gazetarë, juristë, ekspertë të mediave, përfaqësues të institucioneve publike ose OJQ)
- Të dhëna zyrtare statistikore të kërkuara nga institucionet publike ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.

Treguesit A: **Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve**

Në përgjithësi, Kushtetuta e Kosovës dhe korniza ligjore përmbledhin normat dhe garancitë kryesore që mbrojnë lirinë e mediave dhe shprehjes, edhe pse në praktikë zbatimi i tyre është i dobët.

Sa i përket legjislacionit, qeveria e Kosovës prezantoi një iniciativë të dështuar në ndryshimin e Kodit Penal duke planifikuar kthimin e shpifjes dhe fyerjes si vepër penale dhe sanksionimin me burg të individëve apo mediave që shpifin ndaj organeve më të larta shtetërore. (Seksioni A.1)

Gazetarët e intervistuar theksuan se vërshimi i portaleve ka ndikuar për keq sa i takon raportimeve, të cilat publikohen pa verifikimin e burimeve, ndërsa rreziku nga shpifjet mbetet më sfidues.

Po ashtu, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka ndryshuar kodin e vet, duke i trajtuar si shkrimet tjera edhe opinionet e publikuara në mediat e shkruara kur palët e treta kanë ankesa për shpifje dhe fyerje. (Seksioni A.2, faqe 10)

Radiotelevizioni i Kosovës edhe këtë vit është përballur me një numër sfidash. Njëra prej tyre ka të bëjë me mosadoptimin e ligjit të për RTK-në që parasheh rregullimin e financimit dhe çështjet në lidhje me pronën. Gazetarët e intervistuar theksuan se kanë vazhduar ndërhyrjet politike tek pavarësia

[8]

editoriale e transmetuesit publik. (Seksioni A.1)

Në një rast, AGK-ja ka përkrahur pakënaqësinë e gazetarëve që kritikuan Presidentin e Kosovës, i cili nuk u dha mundësi gazetarëve të bëjnë pyetje. Gazetarët ishin të ftuar nga Presidenti, i cili pas përfundimit të fjalimit të tij u largua menjëherë nga foltorja. AGK-ja ka reaguar edhe kundër komunës së Fushë Kosovës, e cila pati vendosur të ndërpresë komunikimin me njërin medium. (Seksioni A.4)

Treguesit B: **Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës**

Kushtet jo të mira të punës dhe pagat e vogla vazhdojnë të jenë ankesat kryesore të gazetarëve. Po ashtu, mungesa e kontratave është sfidë për këtë komunitet, duke krijuar atmosferë pasigurie në punën e tyre. AGK-ja ka qenë në korrespondencë me Inspektoratin e Punës, të cilit i ka përcjellë tri raste të ankesave të gazetarëve; dy raste kanë përfshirë grupe gazetarësh, të cilët janë ankuar për shkelje të ligjit të punës nga ana e punëdhënësit. (Seksioni B.1)

Gjatë fushatës 10 ditore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë vërejtur disa portale që kryesisht kishin për qëllim të shpërndajnë lajme të rreme dhe propagandë negative kundër partive politike dhe individëve në garë për deputetë. Dy raste janë regjistruar në polici nga dy portale kundër një personi të dyshuar për mirëmbajtjen e njërit portal që shpërndante lajme të rreme. (Seksioni B.2)

Sindikata e Pavarur e RTK-së ka reaguar disa herë, duke kritikuar menaxhmentin e transmetuesit publik për keqmenaxhimin e financave dhe punësime pa konkurs. Sindikalistët po ashtu reagues kundër vendimit të drejtorit gjeneral të RTK-së që mori masa disiplinore ndaj kryetarit të sindikatës. Ata e vlerësuan si hakmarrje të drejtorit gjeneral për shkak të aktiviteteve të kryesindikalistit. (Seksioni B.3)

Treguesit C: **Siguria e gazetarëve**

Fillimi i vitit ka shënuar raste të kërcënimeve verbale, kërcënimeve me jetë dhe sulmeve fizike ndaj

gazetarëve. Është vërejtur se deputetët e rinj në Kuvendin e Kosovës, pas zgjedhjeve më 11 qershor, kanë përçuar porosi nxitëse ndaj disa gazetarëve dhe madje në një rast një deputet ka kërcënuar me jetë kryeredaktorin e një portali. (Seksioni C.1)

Institucionet e drejtësisë dhe sigurisë ishin më aktive në mbrojtje të gazetarëve këtë vit pas rekomandimeve të bëra vitin e kaluar nga raporti i AGK-së në lidhje me sigurinë e gazetarëve.

Mirëpo, vërehet se ndjekja ligjore për disa raste, me autorë të dyshuar e të identifikuar, nuk ka ecur në mënyrë efektive duke bërë që rruga deri në gjykatë të jetë më e ngadalshme. (Seksioni C.2)



A

Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve

A.1 A siguron legjislacioni kombëtar garanci për lirinë e mediave dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?

Në përgjithësi, korniza ligjore për rregullimin e mediave i garanton normat themelore për mbrojtjen e lirive të mediave dhe gazetarëve. Teksa kuadri ligjor është i përshtatshëm për lirinë e mediave, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar, zbatimi i tij në praktikë është i dobët. Një nga arsytet e paraqitura për këtë është reagimi i ngadaltë i sistemit të drejtësisë në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, përfshirë edhe disa organizata të shoqërisë civile, kundërshtuan ashpër kur në publik u bë e njohur se ministria e drejtësisë ishte duke hartuar një draft për ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës, duke tentuar që shpifja dhe fyerja të kriminalizohej përsëri.

Projektligji u bë publik kur më 20 prill 2017 zyra ligjore e Ministrisë së Drejtësisë kërkoi kontributin e disa organizatave të shoqërisë civile në lidhje me rishikimin e dekriminalizimit të shpifjes. Sipas draftit të ri, fyerja dhe shpifja ndaj udhëheqësve të shtetit, përfshirë presidentin, do të ishte veprë e rëndë penale, dhe dënimet për shpifje do të ishin prej tre muaj e deri në 5 vjet burgim.

Më tutje, me këto ndryshime të Kodit Penal parashiheshin sanksione për shpifje ndaj shtetit dhe fyerje të simboleve të shtetit. Këto sanksione parashiheshin në nenin 134 si në vijim:

“Kushdo që publikisht, në një takim, ose nëpërmjet shpërndarjes së materialeve të shkruara shpif ndaj një organi kushtetues, Presidentit, Kuvendit, Qeverisë, Gjykatës Kushtetuese të Re-

publikës së Kosovës ose një prej anëtarëve të tyre në këtë kapacitet në një mënyrë të dëmshme për respektimin e shtetit dhe kështu qëllimisht mbështet përpjekjet kundër vazhdimit të ekzistencës së Republikës së Kosovës ose kundër parimeve të saj kushtetuese, do të dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet”, sipas pikës 1 të dokumentit.

Disa organizata të shoqërisë civile e kundërshtuan projektligjin e propozuar nga ministria e drejtësisë për ndryshimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke thënë se me këtë projektligj shkelen thellësisht parimet thelbësore të një shteti demokratik. Protesta u organizua më 3 maj nga AGK-ja me rastin e shënimit të ditës botërore të lirisë së shtypit.

Organizatat protestuese theksuan se kriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes është hap drejt autoritarizmit në Kosovë dhe në kundërshtim të plotë me rrugën e reformave Evropiane. Pas reagimit të shoqërisë civile në vend, ministria e drejtësisë i hoqi këto propozime nga projektligji. Në këtë rast, u kritikua edhe Presidenti i vendit, pasi ishte ai që e themeloi këtë komision, edhe pse ai vetë mohoi të ishte i përfshirë në këto propozime.

Ministria e Drejtësisë u arsyetua se propozimet për këto ndryshime u bazuan në modelet më të mira e të avancuara të Bashkimit Evropian në përgjithësi, e në veçanti të Gjermanisë, duke thënë se është në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga perspektiva e ekspertëve ligjorë dhe aktivistëve nga shoqëria civile, adaptimi i modelit Gjerman nuk ka as kuptim logjik, kryesisht për shkak të mekanizmave të dobët të përgjegjësisë që ekzistojnë në vend, e në këtë rast edhe në sistemin e drejtësisë.

Një eksperte ligjore për media ka thënë se këto tentime të shtetit për rikriminalizim të shpifjes ishin të rrezikshme për të ardhmen e vendit. Ajo shtoi se ministria e kishte gabim kur argumentonte se propozimet ishin në pajtim me Konventën Evropiane, duke theksuar rastin e famshëm Cumpana

dhe Mazare kundër Romanisë (2004)¹ ku Gjykata e Strasburgut e ka bërë të qartë se dënimi me burg për shpifje është në kundërshtim me nenin 10 të Konventës që garanton të drejtën e lirisë së shprehjes.

“Mësimi që ministria Hoxha, presidenti Thaçi, qeveritarët, ligjvënësit dhe të gjithë zyrtarët ligjorë të përfshirë në ligjbërje duhet të nxjerrin nga ky rast është se ka kaluar koha kur copy-paste i ligjeve nga vendet demokratike përbënte arsye të mjaftueshme për të imponuar rregulla e ligje në shoqërinë kosovare.”²

Në vitin 2012, u miratua Kodi i ri Penal dhe ligjvënësit kosovarë hoqën dënimin e mëparshëm me burg për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes. Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes tani rregullon përgjegjësinë ligjore civile për shpifje dhe fyerje³.

Në një shikim të shpejtë, Kuvendi i Kosovës arriti të miratojë ndryshimet për ligjin për të drejtat e autorit në tetor 2016. Këtij ligji i janë shtuar edhe gjashtë nene, ndërsa janë ndryshuar 30 nene të tjera me qëllimin e përafrimit dhe harmonizimit të ligjit me direktivat e Bashkimit Evropian. Një ndër nenet që ka ndryshuar është kohëzgjatja e të drejtave të autorit, nga 10 vjet në 70 vjet⁴.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka marrë pjesë në një konsultim publik përmes kësaj platforme në lidhje me rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. AGK-ja ishte informuar se ministria e financave, si sponsorizues i rregullores, kishte pranuar shumicën e komenteve të asociacionit të dërguar gjatë procesit të konsultimit publik. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja e transparencës dhe llogaridhënies gjatë shpenzimit të parasë publike.

Për këtë, AGK-ja ka kërkuar që institucionet përgjegjëse të obligohen me rregullore që t'i bëjnë publike emrat e anëtarëve të komisioneve që bëjnë vlerësimin e aplikimeve, si dhe planet, rregullat, rezultatet dhe raportet për dhënien e fondeve publike në sektorin joqeveritar.

Kësisoj, mediat do të jenë në gjendje që ta kenë më

1 E qasshme në: <http://www.5rb.com/case/cumpana-and-mazare-v-romania/>

2 Flutura Kusari, eksperte e ligjit të mediave, intervistë e mbajtur më 26 qershor, 2017

3 Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2007/13

4 Ligji Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13022>

të lehtë marrjen e informacioneve nga autoritetet publike për financimin publik të organizatave joqeveritare. Ministria e financave miratoi rregulloren më 13 qershor 2017⁵.

Komisioni parlamentar për media u kritikua për shkak të një mbledhjeje të mbyllur për mediat, ku anëtarët e këtij komisioni kanë votuar për disa ndryshime në projektligjin për RTK-në.

Ishte Sindikata e Pavarur e RTK-së (SPRTK) që reagoi kundër komisionit parlamentar për media, duke vlerësuar se mbledhja e komisionit me dyer të mbyllur për publikun ka shkelur të drejtën e publikut për t'u informuar për median publike. "SPRTK konsideron se diskutimet e mbyllura dhe jotransparenca e bëjnë edhe më të vështirë situatën brenda institucionit", thuhet në reagimin e sindikatës.⁶ Edhe zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë reagoi kundër mbylljes së takimit ku u votuan ndryshimet në këtë ligj, duke shprehur shqetësimin për mungesë të transparencës⁷.

Në maj 2017, qeveria e Kosovës ka miratuar koncept dokumentin që mëton ndryshimin e ligjit për qasje në dokumente publike dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe disa OJQ të tjera kanë qenë të përfshirë në debat dhe i kanë dërguar disa komente zyres së kryeministrit, duke kundërshtuar disa ndryshime të bëra në ligj.

Sipas koncept dokumentit, parashihet të forcohet roli i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ashtu që kësaj të fundit t'i shtohen kompetenca ekzekutive në vendimmarrje në rastet e qasjes në dokumente publike. Kjo agjenci parashihet që të veprojë si shkallë e dytë në të gjitha rastet kur palëve të interesit iu është refuzuar qasja në dokumente publike nga institucioni. Po ashtu, në të gjitha rastet kur institucioni nuk i përmbahet vendimit të Agjencisë, Agjencia do të marrë masa, përkatësisht do ta sanksionojë institucionin gjegjës.

Mirëpo, AGK-ja dhe tri OJQ-të, përmes një letre të datës 6 shtator 2016, dërguar kryeministrit të

athershëm Isa Mustafa, e kanë kundërshtuar këtë pikë të dokumentit duke thënë se "një funksion i tillë është funksionalisht i papërshtatshëm për Agjencinë në fjalë, e cila ka obligim ligjor të mos lejojë publikimin e informatave kur ajo beson se është në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale".

AGK-ja, Instituti Demokratik i Kosovës, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) dhe Flutura Kusari, eksperte e të drejtës së mediave, kanë kërkuar nga zyra e kryeministrit që mos ta ndryshojë ligjin në këtë pikë dhe se Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të jetë institucioni ku palët drejtojnë ankesat kur atyre u refuzohet e drejta për qasje në dokumente publike.

"Ne vlerësojmë që shtimi i kompetencave të Avokatit të Popullit për të detyruar institucionet kompetente për të lëshuar dokumente publike duhet të bëhet në kuadër të ligjit aktual, por asesi duke ia bartur një përgjegjësi të tillë ASHMDP-së", thuhet në letër.

Në vitin 2011, qeveria vendosi që të gjithë tenderët publikë të reklamohen në faqen e Komisionit të Prokurimit Publik të Kosovës. Në atë kohë, media të shkruara të afërta me qeverinë përfituan dhe arritën të mbijetojnë vetëm përmes këtij lloji të të hyrave⁸.

Sipas raportit të punës së qeverisë së Kosovës për vitin 2016, zyra për çështje të komuniteteve kishte ndarë 188 mijë euro për media të komuniteteve jo-shumicë, media multietnike dhe disa produksione.

Ky del të jetë i vetmi mekanizëm i financimit të mediave të minoriteteve nga ana e qeverisë së Kosovës.

Mirëpo, mënyra e shpërndarjes së granteve është kritikuar nga Asociacioni i Gazetarëve Serbë të Kosovës dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, duke thënë se zyra për çështje të komuniteteve brenda zyres së Kryeministrit nuk është transparente, madje prej kësaj zyre është kërkuar raport publik rreth konkurrencës.

5 Rregullore MF - NR - 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=30&CatID=23>

6 Safejournalists.net, Komisioni parlamentar fshehurazi diskuton draft ligjin për RTK, <http://safejournalists.net/ks/komisioni-parlamentar-p%D1%91r-media-takohet-fshehurazi-p%D1%91r-t%D1%91-diskutuar-draft-ligjin-p%D1%91r-rtk/>

7 E qasshme në: https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/19399/eu-kosovo-concerned-over-lack-transparency-amending-rtk-law_en

8 Platforma regjionale e Ballkanit Perëndimor për avokim të lirisë mediave dhe sigurisë së gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, f.18, qasur më 9 gusht 2017: <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raporti-i-plot%C3%AB.pdf>

Asociacioni i Gazetarëve Serbë të Kosovës që e ka përcjellë këtë ngjarje këtë vit thekson sidomos se procesi i dhënies së granteve është i fshehtë. “Madje, edhe pse afati për aplikim për projektet ka qenë 25 maj, zyra ende nuk i ka publikuar rezultatet e këtij njoftimi,” thuhet në reagimin e përbashkët të asociacioneve⁹.

Po ashtu, asociacionet janë duke kërkuar që të bëhen të ditur anëtarët e panelit vlerësues, sikurse edhe kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të panelit.

Më poshtë, ju paraqesim një tabelë të përfituesve të granteve për vitin 2016, të cilën AGK-ja e ka marrë përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

Tabela 1. Lista e OJQ-ve dhe mediave dhe shuma e grantit që kanë fituar

TV Puls – 3.000 Euro	Radio Kontakt Plus – 3.000	Radio Klokot – 3.000	Produksioni Dankos Plus – 3.000
OJQ Radio Vibe – 4.000 euro	Gracanica online@info – 2.000	TV Mreza – 5.000	OJQ Keshili per te drejtat e nxënësve – 1.000
OJQ Etika – 1.000	OJQ dhe Radio Prosperiteti – 1.000	OJQ Kosova online – 2.000	OJQ Medija Centar – 6.000
OJQ Iniciajtiva za razvoj IZRAZ – 7.000	OJQ Centre for proactive action – 8.000	Video produksioni FOKUS – 8,500	Shtëpia botese Glas Naroda – 9,000
OJQ CDR Partesh – 4.000	Max production (Zoran Maksimovic) – 4.000	Radio Gorazdevac – 7.500	OJQ Aktiv – 8.000
OJQ dhe Radio Vala Rinore – 2.000	B92 open – 9.000	RIMA – 9.000	OJQ Akcija zajednick i pomoci – 8.000
OJQ Meridian ZP – 9.000	Bioskop Geto Production – 8.000	Radio Viktoria – 6,000	OJQ Slobodna Produkcija – 7.000
OJQ Srpsko Slovo – 8.000	Produksioni Globus – 5.000	TV MIR – 9.000	Radio KIM – 1.500
OJQ Fortesa Kamenicë – 5.000	OJQ Radio 038 Gracanica – 3.500	TV ZOOM – 8.000	

⁹ Qasshëm në: https://www.facebook.com/pg/asociacioniigazetarëve/posts/?ref=page_internal

Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka vazhduar të jetë cak i kritikave edhe në muajt e parë të këtij viti për lejimin e ndërhyrjes së politikës drejtpërdrejt në pavarësinë e redaksisë. Shpesh ka ndodhur që aktivitete të qeverisë dhe partisë në pushtet të transmetohen si lajme të para në RTK.

Për një kohë të gjatë është vërejtur se lajmet nisnin me aktivitetet e kryeparlamentarit të atëherëshëm, Kadri Veseli. Për këtë kishte reaguar edhe kryeministri Isa Mustafa i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pak kohë pasi formoi qeverinë me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), kur pohoi se RTK-ja më shumë po sillet si medium partiak, duke lënë të nënkuptohet se më shumë kohë po i dedikohet partnerit të saj qeveritar në mediumin publik¹⁰.

Kritika më të ashpra janë bërë nga partia opozitare Lëvizja Vetëvendosje, e cila në disa paraqitje të bëra në fund të vitit 2016 ka kritikuar menaxhmentin dhe një kryeredaktor të RTK-së se po mbajnë haptazi anën e qeverisë.

Në një konferencë për shtyp, Vetëvendosje paraqiti lidhjet e kryeredaktorit me një zyrtar të lartë të njësitit anti-terrorizëm¹¹ i cili kishte zhvilluar hetimet kundër disa aktivistëve të Vetëvendosjes që u arrestuan për sulm terrorist ndaj Kuvendit të Kosovës¹².

Autonomia dhe pavarësia e RTK-së mbrohen me ligj¹³, i cili u miratua në vitin 2012, por që ligjvënësit e krijuan vetëm për tri vite derisa menaxhmenti të gjente një mekanizëm të ri e të pavarur të financimit. Megjithatë, projektligji i ri për RTK-në parasheh mbledhjen e 2,5 euro nga amvisëritë përmes faturimit të energjisë elektrike dhe po ashtu do të ndahen 0,4 për qind nga buxheti i vendit, dhe pritet të miratohet në të ardhmen nga Kuvendi i Kosovës.

Transmetuesi vazhdon të financohet nga buxheti i Kosovës në ciklin e tremujorshit. Prej janarit e deri më qershor 2017, RTK është financuar me 5,5 milionë euro nga buxheti i Kosovës.

¹⁰ Indeksonline, 17 janar 2015, qasur më 11 gusht 2017: <http://telegrafi.com/mustafa-akuzon-rtk-ne-po-sillet-si-medium-partiak/>

¹¹ Insajderi, "VV zbulon lidhjen mes zëvendësredjtorit të antiterrorizmit dhe PDK-së", 30 gusht 2016, qasur më 11 gusht 2017: <http://www.insajderi.com/vv-akuzon-zevendesdrejtorin-e-antiterrorizmit-per-lidhjet-pdk-ne/>

¹² Die Morina, "Anëtarët e Vetëvendosjes të arrestuar për shpërthimin në Kuvendin e Kosovës", 30 gusht 2016, qasur më 11 gusht 2017: <http://www.balkaninsight.com/en/article/vetevendosje-members-arrested-for-bomb-in-kosovo-assembly-08-30-2016>

¹³ Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, neni 18

A.2 A shkakton ligji i shpifjes efekt “trishtues” mes gazetarëve?

Përpjekjet e qeverisë për të dekriminalizuar shpifjen dhe fyerjen kanë qenë të suksesshme në vitin 2012 duke adoptuar Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Me këtë, ky ligj tani nuk shkakton ndonjë efekt ‘trishtues’ mes gazetarëve, sepse sipas këtij ligji gazetarët të cilët shpifin apo fyejnë nuk dënohen me burg sipas Kodit Penal. Së fundmi, qeveria prezantoi një iniciativë të dështuar në amendamentimin e Kodit Penal, e cila do të konsideronte penalisht të përgjegjshëm këdo, përfshirë edhe mediat, që do të shpifte apo fyente një trup kushtetues, përfshirë Presidentin, Kuvendin, Qeverinë dhe Gjykatën Kushtetuese, duke parashikuar dënime nga tre muaj deri në pesë vite burgim.

AGK në bashkëpunim me Gjykatën Themelore në Prishtinë ka arritur të nxjerrë numrin më të saktë të rasteve të shpifjeve dhe fyerjeve. Sipas regjistrimit të gjykatës, gjithsejtë janë 59 raste kundër shpifjes dhe fyerjes, e që datojnë që nga viti 2009. Po ashtu, sipas gjykatës, vetëm dy raste janë trajtuar nga gjykata në Prishtinë, ku të dy paditë janë tërhiqur prapa për shkak të mosinteresimit të paditësve.

Nga këto 59 raste, 10 janë ngritur nga zyrtarët shtetëror madje shumica prej tyre janë figura të larta. 5 raste janë ngritur nga avokatë dhe gjyqtarë kundër gazetarëve dhe mediejeve. 6 raste janë ngritur nga mediumi/gazetari kundër një mediumi/gazetari tjetër.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë hapa për të zbatuar njëri nga rekomandimet e nxjerra vitin e kaluar në raportin e AGK-së, “Treguesit e Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve”. Gjykata Themelore, respektivisht zyra për komunikim me media, tani ka një qendër të dhënash të rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe profesionistëve tjerë media. Po ashtu, gjykata e Prishtinës ka nisur me procedimin e rasteve penale që përfshijnë kërcënime ndaj gazetarëve. Gjatë muajve tetor dhe nëntor janë mbajtur tri seanca gjyqësore, dy raste të shpifjes dhe një penale.

Nga ana tjetër, gazetarët e intervistuar theksojnë se vërshimi i portaleve të reja në skenën mediale duke plasuar shpesh lajme pa verifikim të burimeve ka çënuar standardet profesionale dhe kodin e etikës. Kjo kryesisht ndodh për shkak të ‘fuqisë së klikimeve’, pasi portalet janë më shumë të interesuara për shpejtësinë, dhe jo për verifikime. Sipas vlerësimit të gazetarit Përparim Isufi,

“shpifje ka nëpër portale, ka edhe nëpër media të mëdha. Por nuk e di kush është gjyku deri më sot. Nuk e mbaj në mend ndonjë proces gjyqësor që është duke ndodhur për shpifje”¹⁴

Po ashtu është vërejtur se opinionet që botohen nëpër disa media online kanë në fokus sulmin ndaj një individi apo më shumë individëve, teksa kryesisht mungojnë faktet për të argumentuar dhe e videntuar opinionin e shprehur. Palët e përfshira në këto opinione janë ankuar në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), por ankesat nuk janë aprovuar me arsyetimin se këshilli nuk i trajton opinionet në kodin e vet.

Ndërsa, që nga shkurti 2017, Këshilli ka ndërmarre masa që të plotësojë kodin e vet duke sqaruar se edhe opinionet e botuara duhen të respektojnë rregullat etike.

“Kodi i vjetër na ka obligu që mos me i trajtu opinionet. Tash është ndërruar kodi dhe opinioni trajtohet si shkrimet e tjera,”¹⁵

është shprehur Kryetari i KMSHK-së, Imer Mushkolaj.

Megjithatë, sipas ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, respektivisht nenit 8 që flet për opinionet, gjykata nuk do ta konsiderojë dikë përgjegjës për shpifje apo fyerje për sa kohë që opinioni shpreh një qëllim të mirë dhe është i bazuar në ndonjë fakt. Vitin e kaluar, AGK-ja ka raportuar për një numër të padive për shpifje, por ato nuk janë procesuar nga gjykata në Prishtinë.

Në raportin e vitit të kaluar janë paraqitur 20 padi për shpifje kundër gazetarëve. Nga ky numër, dy padi janë ngritur në gjykatë kundër një portali nga dy deputetë të së njëjtës parti. Ndërsa, pesë raste përfshijnë paditë e gazetarëve kundër gazetarëve që akuzojnë njëri tjetrin për shpifje dhe fyerje.

14 Përparim Isufi, gazetar, intervista e mbajtur më 19 maj 2017

15 Imer Mushkolaj, kryetar i KMSHK-së, intervista e mbajtur më 19 qershor 2017

A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatave zgjedhore?

Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që i detyron mediat në Kosovë në raport me pluralizmin politik në periudhat jo zgjedhore, por kjo çështje është e rregulluar me kod të sjelljes për të gjitha mediat. Në përgjithësi ekziston pluralizmi në mediat e Kosovës, duke përfshirë mediat transmetuese, të shtypura dhe online. Kushtetuta e Kosovës ofron garanci për pluralizmin e mediave¹⁶. Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave gjithashtu mbështet liritë dhe pluralizmin e shërbimeve mediatike audio-vizuale në Kosovë.¹⁷

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka monitoruar mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve të parakohshme të përgjithshme të mbajtura më 11 qershor 2017. Partitë politike kishin vetëm dhjetë ditë të fushatës që të paraqisnin programet e tyre para elektoratit. Monitoruesit e komisionit kanë monitoruar mediat prej orës 16:00 e deri në orën 24:00, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, spotet politike si dhe intervistat e debatet në transmetimet televizive.

Sipas raportit të KPM-së,¹⁸ mbulimi i fushatës elektorale nga mediat ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm. Megjithatë, monitoruesit kanë gjetur disa shkelje që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore e sidomos transmetimin e spoteve me prezencë të fëmijëve, çka ndalohet me ligj. Spotet janë bërë nga dy koalicionet parazgjedhore, PAN (Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma) dhe LAA (Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca Kosova e Re dhe Alternativa) si dhe nga dy partitë politike, GiSL (Iniciativa Qytetare Lista Serbe) dhe SLS (Partia Liberale Serbe). Në rastin e spotit të koalicionit LAA, transmetuesi publik e ka larguar këtë spot pas transmetimeve të para. Ndërsa, spotet e tjera me fëmijë, edhe pse KPM-ja iu ka dërguar një shkresë mediave që t'i largojnë këto spote, shumica prej tyre kanë vazhduar me transmetimin e tyre.

KPM-ja po ashtu ka gjetur shkelje në disa spote politike që nuk identifikoheshin nëpër televizione nëse janë ose jo me pagesë. Pas një shkrese të komisionit, televizionet kanë bërë identifikimin nëse spotet janë bërë me pagesë ose jo. Shkelje tjetër është gjetur në kohën e periudhës së heshtjes zgjedhore, kur televizionet kanë transmetuar konferenca për media të disa partive politike ku janë vërejtur logot dhe simbolet e tyre. Po ashtu, monitoruesit kanë gjetur shkelje të kodit të etikës në televizionet në gjuhën serbe që kanë transmetuar spotin e partisë politike Lista Serbe ku përdorshin shprehje kundër “formimit të ushtrisë së Kosovës”, bëhej thirrje për “ruajtje nga shuarja e institucioneve të Republikës së Serbisë”, dhe përdorej shprehja “Kosovo i Metohija”.

Në ndërkohë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka lëshuar një komunikatë për shtyp, duke tërhequr vëmendjen e lexuesit dhe aktorëve të tjerë dhe duke iu kërkuar që të kenë kujdes gjatë konsumimit të informatave nga portale të dyshimta, të cilat ishin shfaqur para dhe gjatë fushatës zgjedhore. AGK-ja ka vërejtur shpërndarjen e dezinformatave nga portale të dyshimta që shfrytëzojnë edhe mediat sociale, në veçanti Facebook-un. AGK-ja ka monitoruar dhe ka gjetur së paku pesë faqe në Facebook të cilat paraqiteshin si portale dhe shpërndanin lajme të rreme, duke sulmuar individë apo parti politike. Këto portale të rrejshme në Facebook kamufloheshin duke përdorur logo dhe motive të mediave të njohura dhe kështu shtrembëronin informacionet.

Në qershor 2017, dy portale kanë raportuar në polici keqpërdorimin e logove të tyre nga një portal i rremë dhe një person është i dyshuar për shpërndarje të lajmeve të rreme. Rasti është ende nën hetime të policisë.

Zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme në Kosovë janë vëzhguar edhe nga vëzhguesit e Bashkimit Evropian.¹⁹ Në raportin e tyre thuhet se mediat në përgjithësi kanë ofruar qasje në informacione për votuesit për opsione të ndryshme politike. Raporti po ashtu thekson se televizionet dhe mediat online

¹⁶ Kushtetuta e Kosovës, neni 42

¹⁷ Ligji Nr. 04/L-044 për komisionin e pavarur për media, neni 5

¹⁸ KPM, Raport monitorimi i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme 2017, qasur më 11 gusht 2017: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1499342536.8299.pdf>

¹⁹ European Union Election Observation Mission, Preliminary statement, 13 qershor 2017, f.7, qasur më 20 gusht 2017: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eu_eom_kosovo_2017_ps_en.pdf

ishin burimet kryesore të informimit për votuesit, dhe u janë shmangur porosive nxitëse.

Televizioni publik dhe televizionet private kanë raportuar ndërhyrje nga partitë politike, të cilat kanë tentuar të ndikojnë që kushtet e debateve politike të shkonin në favor të tyre, duke bërë kërkesa që ishin në kundërshtim me ligjin. Sipas vëzhguesve ndërkombëtarë, televizioni publik RTK, kanali i parë, dhe dy televizionet private RTV 21 dhe KTV, kanë ofruar në lajmet e tyre mbulim të barabartë për tri partitë më të mëdha, gjersa televizioni privat Klan Kosova ka ofruar më shumë hapësirë për koalicionin PAN.

A.4 A është liria e punës dhe asocimit të gazetarëve e garantuar dhe e zbatuar në praktikë?

Në Kosovë gazetarët nuk kanë obligim ligjor që të licensohen nga ndonjë institucion shtetëror. Liria e asocimit është e garantuar me Kushtetutën e vendit përmes nenit 44 dhe po ashtu me Ligjin 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në OJQ.²⁰

Ligji në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por legjislacioni dytësor, në fuqi nga viti 2014, ka bërë që regjistrimi i organizatave jo-qeveritare të jetë më i vështirë në procedura. Tërë kjo ka ardhur për shkak të pezullimit të 16 OJQ-ve për të cilat organet e sigurisë në vend kanë theksuar se kanë zhvilluar veprimtari të dyshimta dhe kanë lidhje me grupet që shpërndajnë islamism radikal në Kosovë.²¹

Në Kosovë janë dy asociacione të gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë që të anëtarësuar ka kryesisht gazetarë të komunitetit serb. Në Kosovë vazhdon të mos ketë sindikatë që përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medialë.

Viteve të fundit nuk ka pasur asnjë debat në lidhje me këtë çështje. Kur gazetarët kanë pretenduar se iu kanë shkelur të drejtat e punës, ata i janë drejtuar AGK-së, e cila i ka këshilluar për hapat e mëtejme.

Megjithatë, ka sindikata të tjera për të punësuarit në kuadër të transmetuesit publik, e këto janë dy, Sindikata e Pavarur e RTK-së (SPRTK) dhe Sindikata e punëtorëve të RTK-së. Në korrikun e kaluar, SPRTK ka reaguar kundër menaxhmentit për shkak të punësimeve të pakontrolluara që po ndodhin në transmetuesin publik.²² Sindikalistët theksuan se menaxhmenti nuk është duke i përfillur rekomandimet e Auditorit Gjeneral për mospunësime të reja për shkak të gjendjes së vështirë financiare të Transmetuesit Publik, përfshirë borxhet milionëshe.

Sindikata ka ftuar Inspektoratin e Punës që të bëjë hetimin e këtyre punësimeve. SPRTK-ja ka kritikuar menaxhmentin dhe bordin e RTK-së edhe në të kaluarën për shkak të keqmenaxhimit të financave.

Më 8 shkurt 2017, AGK-ja ka reaguar kundër drejtorit gjeneral të RTK-së Mentor Shala, i cili në një postim në llogarinë e tij në Facebook ka ofenduar dhe kërcënuar punëtorët e mediumit publik. Punëtorët e mediumit publik njoftuan se ky reagim i z.Shala vinte pas takimeve të ndara që drejtuesit e Sindikatës së Pavarur të RTK-së kishin zhvilluar me kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe me të gjitha grupet parlamentare lidhur me hartimin e ligjit për RTK-në dhe gjendjen e përgjithshme në Transmetuesin Publik. Shala i kishte krahasuar sindikalistët me “bakterie politike në RTK” duke shtuar se “për secilën bakterie ka antibiotik”.

Më 14 shkurt 2017, AGK-ja ka reaguar kundër komunës së Fushë Kosovës, e cila kishte marrë vendim për ndërprerje të komunikimit me gazetarët e Televizionit Kohavision. Për AGK-në, kjo ishte shkelje e parimeve për respektimin e transparencës dhe ka kërkuar nga komuna që ta tërhiqte atë vendim.

Po ashtu, AGK-ja ka reguar kundër zyrës për informim të Prokurorisë së Shtetit për shkak se kjo e fundit ka pasur një korrespondencë të ashpër me gazetaren e së përditshmes “Koha Ditore”.

Zyra për informim e prokurorisë e ka quajtur gazetaren “të paedukatë dhe të paaftë” kur gazetarja kërkonte përgjigje në lidhje me një artikull. Gazetarja ka treguar se zyra për informim e prokurorisë

²⁰ I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2764>

²¹ Mentor Gjergjaj, “Shteti ua pezulloi sërish punën 16 organizatave që dyshohen për lidhje me grupe radikale (Dokument) [State cancelled again the work of 16 organisations suspected for connections with radical groups (Document)],-

-Gazeta Express, 9 janar, 2017. Qasur më 1 gusht 2017: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/shteti-ua-pezulloi-serish-punen-16-organizatave-qe-dyshohen-per-lidhje-me-grupe-radikale-dokument-304696/?archive=1>

²² I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2764>

ka kërcënuar gazetën për moskthim të përgjigjeve në të ardhmen. AGK-ja ka kërkuar nga zyra për informim e Prokurorisë së Shtetit të bashkëpunojë me të gjithë gazetarët pa përjashtim.

Në një rast tjetër, AGK-ja ka reaguar kundër Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, i cili më 30 tetor 2016 pati ftuar mediat në një konferencë për shtyp, por në fund të saj nuk pranoi asnjë pyetje nga gazetarët. AGK-ja reagoi për këtë veprim të Presidentit Thaçi duke thënë se ai nuk respektoi gazetarët dhe injoroi punën e tyre. AGK-ja ka kërkuar nga Presidenti që në daljet e tij të ardhshme përpara gazetarëve të pranojë pyetje dhe të përgjigjet në to, pasi presidenca si institucion duhet të jetë pikë reference e transparencës.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës me Këshillin për Mediat e Shkruara të Kosovës dhe të përkrahur nga organizata të shoqërisë civile organizuan një aksion protestues në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit më 3 maj 2017 para objektit kryesor të qeverisë në Prishtinë.

#Folmosutut ishte motoja e aksionit që për qëllim ka kundërshtimin e tendencave të kufizimit të lirisë së mediave dhe shprehjes në përgjithësi. Në këtë protestë u protestua kundër iniciativës së dështuar të Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku mëtohej të rikriminalizohej shpifja dhe fyerja. Në këtë protestë po ashtu u ngrit zëri kundër mosndëshkueshmërisë nga sistemi i drejtësisë i rasteve të sulmeve fizike dhe kërcënimeve me jetë ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medialë.

A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

Burimi i gazetarëve mbrohet me ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më gusht 2013 dhe konsiderohet si një hap i rëndësishëm për punën e gazetarëve.²³ Viteve të fundit nuk është shënuar ndonjë rast kur ndonjë gazetar i është kërkuar nga ndonjë gjykatë që të zbulojë burimin e informacionit.

Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë përmban vetëm dhjetë nene dhe zbatohet për gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave që janë të angazhuar në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit nëpërmjet mediave. Sipas ligjit, gazetarët dhe profesionistët e mediave kanë të drejtë të heshtin në lidhje me burimet e tyre të informacionit.

Gazetarët detyrohen t'i zbulojnë burimet e informacionit vetëm me urdhër të gjykatës, kur është e nevojshme për të parandaluar kërcënim serioz që do të çonte në vdekjen e një apo më shumë personave.

Më tej, ligji ndalon bastisjen e ndërtesave të kompanive mediatike dhe pronave të tjera të mediave, të tilla si makina apo shtëpi të gazetarëve, nëse merret ndonjë masë e hetimit që ka për qëllim të identifikojë burimin e informacionit. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, sepse fillimisht çështja e burimeve adresohet përmes Kodit Penal. Megjithatë, pas një numri protestash u eliminuan kufizimet e pajustificueshme e të dëmshme për gazetarët në përmbajtjen e mediave në lidhje me burimet.

Në raportin e vitit 2016, shumica e gazetarëve të intervistuar përmes anketës janë përgjigjur se ndihen të lirë të mbajnë kontakte me burimet e informacionit gjatë raportimit mbi çështjet e interesit publik. Gazetarët e anketuar (44,4%) thanë se është rritur disi ndërveprimi me burime, identiteti profesional i të cilëve duhet të respektohet. (23 të anketuar nga 50 nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje, sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari).²⁴

Po ashtu, në raportin e njëjtë, gazetarët e intervistuar kanë theksuar se zyrtarët e policisë, gjyqësorit dhe prokurorisë duhen të trajnohen për të kuptuar këtë dhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me mediat. Trajnimi mund të jetë një mjet i dobishëm për t'i diskutuar këto ndryshime dhe për ta sjellë në vëmendjen e bartësve obligimin e tyre.

Përveç kësaj, mund të jetë e nevojshme që të ketë procese brenda institucioneve të ndryshme në mënyrë që çdo kërkesë të bëhet në mënyrë zyrtare dhe të jetë e bazuar, duke kufizuar ndikimin e trysnisë nga institucione të veçanta, në qoftë se do kishin këtë qasje në trajtimin e burimeve. Gjykatat do të kenë një rol të rëndësishëm duke treguar qasjen, disponueshmërinë dhe aftësinë për t'u marrë me raste të tilla menjëherë.

A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?

Ligji për qasje në dokumente zyrtare është miratuar në vitin 2010, duke shfuqizuar ligjin e vitit 2007.²⁵ Ndryshimet e fundit në ligj kanë ndikuar në shkurtrimin nga 15 ditë në 7 të disa afateve të institucioneve shtetërore për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion.

Siç e kemi cekur edhe më lart, qeveria e kaluar në mbledhjen e saj më 15 maj 2017, ka aprovuar koncept dokumentin për qasje në dokumente publike, si fillim i procedurave për aprovimin e ligjit të ri. Një objektiv i koncept dokumentit është përcaktimi i shkallës së dytë dhe të tretë për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Për këtë objektiv ka reaguar AGK-ja në komentet e saja, pasi është paraparë që të forcohet roli i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që do të veprojë si shkalla e dytë në të gjitha rastet kur palëve të interesit u refuzohet qasja në dokumente publike.

AGK-ja, së bashku me disa OJQ konsiderojnë se një vlerësim i tillë është i papërshtatshëm për këtë

23 Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

24 Platforma regionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2016, f.27. Qasur më 15 gusht 2017: <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raporti-i-plot%C3%AB.pdf>

25 Ligji Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike Institucioni i Avokatit të Popullit, email drejtuar autorit më 9 gusht 2017

26

agjenci, pasi kjo e fundit e ka obligim ligjor të mos lejojë publikimin e informative kur beson se është në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale.

Grupi i shoqërisë civile ka rekomanduar që të forcohet roli i Avokatit të Popullit në qasjen e dokumenteve publike, duke bërë që vendimet e tij të jenë të obligueshme për institucionet. Për momentin, vlerësimet e Avokatit të Popullit janë në formë rekomandimesh dhe si të tilla nuk kanë fuqi ekzekutive.

Avokati i Popullit ka vlerësuar rekomandimet e grupit të shoqërisë civile, duke shtuar se për një gjë të tillë duhen të bëhen ndryshime në Kushtetutë dhe në Ligjin për Avokatin e Popullit.

“Vendimet përfundimtare të institucioneve publike të cilat merren lidhur me kërkesat për QDP (qasje në dokumente publike), janë vendime të shkallës së parë të karakterit administrativ, andaj apriori procedurat ankimore duhet të zhvillohen pranë një organi/mekanizmi, i cili do të jetë organ i shkallës së dytë me fuqi ekzekutive në vendosjen e ankesës kundër vendimeve, për refuzim të plotë apo të pjesërishtëm për QDP.”²⁶

Në raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2016 thuhet se ky institucion ka hetuar 26 ankesa lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, nga të cilat vetëm dy janë bërë nga gazetarët.

Në intervista gazetarët shprehën se tashmë nuk e praktikojnë dërgimin e ankesave tek Avokati i Popullit kur iu refuzohet qasja në dokumente publike, sepse nuk e shohin të arsyeshme dhe është humbje kohe për ta.

“Ndoshta duhet të inkurajohen gazetarët që të përdorin këtë, por në aspektin praktik, në rastin tim personal nuk është se më shërben shumë [...] deri sa ti bën ankesa, shkruan shkresa, në anën tjetër duhet të përfundosh temën, sepse ke një afat.”²⁷

E njëjta gazetarë ka theksuar se një kërkesë për qasje në dokumente publike dërguar ministrisë së

shëndetësisë i është refuzuar kur ka kërkuar të dijë se cilët nga zyrtarët shtetërorë kanë marrë ndihma financiare kur i kanë kërkuar për qëllime shëndetësore.

Ndërsa, raporti i Zyres së Kryeministrit për vitin 2016 për realizimin e qasjes në dokumente publike nga të gjitha institucionet shtetërore thekson se 2.050 nga 2.169 kërkesa, ose 94,5% e të gjitha kërkesave, kanë marrë qasje në dokumente publike. Në raport thuhet se 22 kërkesa janë refuzuar dhe 12 kërkesave u është lejuar qasje e kufizuar.²⁸

Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë e tjera të varësisë kanë marrë gjithsej 671 kërkesa dhe 599 prej tyre kanë pasur qasje në dokumente. Gjatë vitit 2016, më shumë se gjysma, përkatësisht 62 për qind e kërkesave për qasje në dokumente të paraqitura në Qeverinë e Republikës së Kosovës janë bërë nga gazetarët, ku 53 për qind e kërkesave ishin për dokumente që përbajnë statistika.

Në përgjithësi, takimet e kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe takimet e komisioneve parlamentare ishin të hapura për publikun dhe për gazetarët. Po ashtu, në përgjithësi seancat gjyqësore ishin të hapura për media, ndërsa në dy raste gjyqtarët kanë ndaluar mediat që të marrin pjesë në seancat, për çka AGK ka reaguar. Njëri gjykim përfshinte ish-kryetar-in e Gjykatës së Apelit i akuzuar për korrupsion dhe në reagim ishte përfshirë edhe prokurori i rastit që ishte pajtuar me vendimin e gjykatës për mbyllje të të gjitha seancave për media dhe publik.²⁹


Rasti i dytë ka të bëjë po ashtu me korrupsion, ku të akuzuar janë 58 persona, prej tyre 44 mjekë dhe ish-ministri i shëndetësisë.

Për këto dy gjykime AGK-ja ka reaguar duke thënë se këto vendime të gjyqtarëve do të inkurajojnë të akuzuarit e tjerë që të kërkojnë mbyllje të seancave gjyqësore. AGK-ja ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të mos lejojë vendime të tilla të gjyqtarëve, sepse krijohen precedente për fshehjen nga publiku të veprimeve të dyshuara kriminale të zyrtarëve të lartë shtetërorë.

²⁷ Saranda Ramaj, gazetarë, intervistuar më 18 maj 2017

²⁸ <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/SHQIP.pdf>

²⁹ E qasshme në: <http://safejournalists.net/ks/keep-courts-open/>



B

Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?

Në Kosovë, gazetarët vazhdojnë të punojnë në kushte të këqija ekonomike dhe shoqërore. Problemi më i madh për mediat vazhdon të jetë paqëndrueshmëria e tyre financiare. Gjendja e rëndë ekonomike në vend ka ndikuar edhe në media, të cilat burimin e tyre të vetëm e kanë nga të hyrat e marketingut.

Gazetarët e intervistuar kanë thënë se ky komunitet vazhdon të punojë në kushte jo të favorshme për ta për shkak të mungesës së kontratave të punës apo të pagave të vogla e që paguhen me vonesë. Në këto vite të fundit është vërejtur një interesim më i madh i gazetarëve që të punësohen në Radiotelevizionin e Kosovës për shkak të një page të sigurtë. Gazetarët kanë braktisur mediat private për shkak të mospagesave të pagave apo pagesave të dobëta.

“Ka gazetarë që punojnë këtë punë dhe e shfrytëzojnë si katapultim për të kaluar në institucionet shtetërore. Dhe nuk është faji i tyre, sepse është vështirë të mbijetosh me 300 euro pagë. Ose është problemi tjetër që të gjithë dëshirojnë të shkojnë në RTK, sepse është publik dhe është rroga më e madhe.”³⁰

Aktualisht, transmetuesi publik gjendet në telashe financiare, kryesisht për shkak të mosmiratimit të ligjit të ri nga ana e Kuvendit të Kosovës, që do të zëvendosojë ligjin e vjetër e të skaduar që nga dhjetori 2015.

Edhe pse në raste të rralla, gazetarët në Kosovë nuk gëzojnë mbrojtje të duhur sociale, as ato thelbësore si sigurimi shëndetësor, e as ndonjë pushim mjekësor të paguar. Është një numër i vogël i mediave private që i përfshijnë këto beneficione për punëtorët medialë.

“Mbrojtja sociale shihet si luks nëpër mediat në Kosovë”, tha një gazetar në intervistë.³¹

Në Kosovë nuk ka statistika zyrtare mbi pagat në media. Mirëpo, sipas anketës së realizuar me gazetarë dhe redaktorë në vitin 2016, pothuajse gjysma e gazetarëve deklaruan se pagat e tyre mujore shkojnë nga 200 deri në 500 euro. Ndërsa pagat e redaktorëve shkojnë nga 600 deri në 900 euro (përfshirë këtu edhe pagat në transmetuesin publik).³²

AGK-ja i ka dërguar tri shkresa Inspektoratit të Punës në emër të disa gazetarëve të cilët janë ankuar për shkelje të të drejtave të tyre nga tre punëdhënës të ndryshëm. Inspektorati i punës i ka trajtuar të trija rastet.³³ Në dhjetor 2016, AGK-ja ka përcjellë në inspektorat të punës rastin e një gazetares, e cila kishte deklaruar se e kishin larguar nga puna pasi menaxhmenti i lartë kishte kuptuar se ajo ishte shtatëzënë.

Inspektorati kishte vendosur që punëdhënësi ta kompensonte gazetaren më një pagë mujore, sepse nuk e ka njoftuar atë me kohë dhe po ashtu i ka rekomanduar punëdhënësit që të nxjerrë një vendim të ri për shkeljet të kontratës, pasi vendimi i vjetër ishte i pakuptueshëm.

Rasti i dytë ka të bëjë me ankesën e disa kameramanëve, të cilët janë ankuar për shkak të mospaguesës së disa pagave nga një punëdhënës në Prishtinë. Televizioni privat në Prishtinë ndaloi së paguari pagat për punëtorët duke paguar një muaj ndërsa muajin vijues nuk paguante.

Kësisoj punëdhënësi ka krijuar borxhe ndaj punëtorëve të vet, duke u akumuluar deri në katër muaj paga. Borxhi më i lartë për një punëtor është grumbulluar deri në afër 1.000 mijë euro. Inspektorati i Punës ka faktuar gjendjen pas kontrollimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke kërkuar nga punëdhënësi që t'i paguante borxhet.

Punëdhënësi u ankuar kundër vendimit, ndërsa inspektorati e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërte-toi vendimin e shkallës së parë, me autoritetin që ka inspektori – vendimi merret si formë e prerë. AGK-ja ka kuptuar nga një ankues se ish-punëdhënësi nuk i ka ekzekutuar pagesat dhe ata kanë deponuar ankesë në gjykatën e Prishtinës dhe presin fillimin e gjyqimit.

Po ashtu, një grup gazetarësh anonimë janë ankuar ndaj punëdhënësit të tyre për shkak të mosrespektimit të ligjit të punës. Gazetarët theksuan në letrën e tyre se ata janë të privuar nga pushimet javore dhe vjetore. Ankesa e përgatitur nga juristi i asociacionit, me numër P/14, e datës 20 qershor 2017, i dorëzohet zyres së inspektoratit të punës për verifikim.

Sipas ankuesve, asnjë prej punëtorëve nuk gëzon të drejtën e pushimit vjetor. Inspektorati vizitoi punëdhënësin më 25 korrik 2017 dhe konstatoi se ka qenë e pamundur që të konstatohen shkeljet e supozuara.

“Të gjitha pretendimet e cekura në informacion të AGK-së, në bazë të dokumentacionit të prezantuar nga Punëdhënësi, ka qenë e pamundur të konstatohen, prandaj dhe Raporti zyrtar përfundimtar nuk është përpiluar.”³⁴

Në takime joformale me gazetarë dhe profesionistë të tjerë medialë tregohet për gjendjen e rëndë të kushteve të punës. Pagat janë kryesisht të ulëta dhe siç u tha më lart ka vonesa të pagave. T’ju rikujtojme anketën e bërë vitin e kaluar, ku gazetarët ishin pyetur nëse ka pasur rritje ose ulje të pozitës së tyre ekonomike.³⁵

Pothuajse gjysma e tyre (13 ose 48%) tha se nuk kishte asnjë ndryshim, që do të thotë se situata është po aq e keqe sa më parë. 9 (33%) u përgjigjën “është zvogëluar disi”, ndërsa 3 gazetarë (11%) u përgjigjën “rritur disi”.

Një gazetar zgjodhi opsionin “rritur shumë”, dhe një gazetar tha se ka pasur “shumë rënie”. Gazetarët vijojnë të tregojnë se ata punojnë në kushte jo të mira të punës, madje u mungojnë edhe gjërat elementare në punë.

30 Gazetar anonim, intervista e mbajtur më 25 prill 2017

31 Përparim Isufi, gazetar, intervista e mbajtur më 19 maj 2017

32 Po aty19, f.32

33 Inspektorati i punës email autorit më 31 gusht 2017

34 Lulzim Arni, email autorit më 31 gusht 2017

35 Në anketën e vitit të kaluar kanë marrë pjesë 50 gazetarë, ku 27 prej tyre kishin të drejtë në këtë pyetje (23 prej tyre nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari).

“Mua më mungon kompjuteri për të punuar, më mungon karrika, nuk kam hapësirë për të punuar, pra më mungojnë gjërat elementare nëse bëjë krahasim me vendet e tjera ku kam punuar.”³⁶

B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e mediave dhe strukturat udhëheqëse?

Në Kosovë, niveli i pavarësisë editoriale është i ulët. Mediat më të mëdha kanë struktura të ndara organizative që i mbajnë redaksitë të ndara nga menaxhmenti dhe departamenti i marketingut. Mirëpo, duke pasur parasysh se reklamat janë burimi i vetëm i të hyrave nëpër media, herë pas here menaxherët apo pronarët e mediave ndikojnë nëpër redaksi që të largojnë shkrimet që kritikojnë kompanitë që janë reklamues të mëdhenj.

Të pakta janë mediat që kanë miratuar kode të brendshme të etikës. Të tjerët janë në pajtim me kodin e përgjithshëm të etikës të miratuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës për mediat e shtypura. Transmetuesit privatë janë në pajtim me kodin e përgjithshëm të etikës së Komisionit të Pavarur për Media.

Është vërejtur shumë nëpër artikuj tek mediat online që nuk i publikojnë emrat e gazetarëve dhe figuron vetëm emri i medias. Këto portale shquhen për numër të vogël të gazetarëve në redaksi dhe një numër i tyre i mbajnë anën ndonjë partie politike. Një numër sosh janë vërejtur gjatë fushatës zgjedhore të fundit në vend duke zhvilluar një propagandë të madhe për parti apo individë. Në anën tjetër, gazetarët e intervistuar sivjet theksojnë se pronarët janë ata që përmes redaktorëve diktojnë politikën e tyre editoriale tek gazetarët, prej të cilëve kërkohet që të shkruajnë lajme në favor të ndonjë partie politike.

“Më tregojnë disa kolegë që punojnë në një televizion, ku redaktori ka kërkuar nga gazetarët që mbulojnë politikën, për shembull në kohën kur demarkacioni ishte temë në kuvend të Kosovës, me e cilësu si normale ratifikimin e demarkacionit”.³⁷

- 36** Gazetar anonim, intervista e mbajtur më 24 maj 2017
- 37** Durim Abdullahu, gazetar, intervista e mbajtur më 23 maj 2017
- 38** Po aty 28
- 39** Koha Ditore, “SPRTRK reagon për punësime të

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?

Në praktikë, RTK-ja ushtron pavarësi të ulët editoriale. Radiotelevizioni i Kosovës ka kodin e vet të sjelljes që quhet “Standardet profesionale dhe parimet etike në programet e RTK-së” dhe konsiderohen si standarde të avancuara. Mirëpo, transmetuesi publik vazhdon të jetë i kritikuar për anshmëri për shkak të ndërhyrjes së drejtpërdrejt politike në pavarësinë editoriale, madje ekziston një bindje e hapur në gazetarët e intervistuar se këto standarde nuk përfillen.

“RTK më shumë shihet si ent punësimi sesa informativ”.³⁸

Sindikata e pavarur e RTK-së (SPRTRK) ka ngritur disa herë shqetësimet e saj, duke kritikuar menaxhmentin në lidhje me financat dhe nepotizmin. Së fundmi, kjo sindikatë ka reaguuar për punësime, siç thonë ata, të pakontrolluara në transmetuesin publik, madje në disa raste edhe pa konkurs. Sindikata theksoi se menaxhmenti nuk është duke përfillur rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për mospunësime për shkak të gjendjes së vështirë financiare.³⁹

Viteve të fundit, sindikata ka kërkuar disa herë nga prokuroria që të fillojnë hetimet në lidhje me manipulimet financiare që po ndodhin tek transmetuesi publik. Më 13 mars 2017, sindikata ka kërkuar sqarim nga menaxhmenti dhe bordi i RTK-së në lidhje me shpenzimet e 37.500 eurove që janë bërë në emër të sigurimeve për punëtorët për periudhën janar-mars 2017. Sindikalistët rikujtuan se punëtorët e RTK-së kanë mbetur pa sigurim shëndetësor që nga 1 janari i këtij viti.⁴⁰

Qasje e ashpër mes menaxhmentit të RTK-së dhe sindikatës ka vazhduar edhe këtë vit. Në fillim të marsit, menaxhmenti kishte nisur masa disiplinore kundër kryetarit të sindikatës, Fadil Hoxha, për shkak se ky i fundit përmes qëndrimeve të tij publike ka dëmtuar imazhin e RTK-së. Sindikalistët reagueshan

pakontrolluara në RTK”, 20 korrik 2017. Qasur më 15 gusht 2017: <http://www.koha.net/arberi/32862/sprtrk-se-reagon-per-punesime-te-pakontrolluara-ne-rtk/>

40 Koha Ditore, “SPRTRK akuzon drejtuesit e RTK-së për manipulim financiar”, 13 mars 2017. Qasur më 15 gusht 2017: <http://www.koha.net/arberi/5393/sprtrk-akuzon-drejtuesit-e-rtk-se-per-manipulim-financiar/>

kundër këtij veprimi, duke thënë se qëndrimet publike të kryetarit janë në pajtueshmëri me ligjin vendor për sindikatat. Për më shumë, drejtori gjeneral i RTK-së, Mentor Shala kishte akuzuar sindikalistët edhe më herët përmes një statusi në Facebook duke i quajtur 'bakterie politike', dhe se ka 'antibiotikë' për ta, dhe se 'pa RTK-në, as qentë nuk i hanë'. Shala i ka bërë këto komente pas takimit të sindikalistëve me kryeparlamentarin dhe grupet parlamentare në lidhje me projektligjin e RTK-së. AGK-ja ka reaguar kundër fjalorit të drejtorit Shala, duke thënë se gjuha e përdorur nga ai paraqet ofendim dhe kërcënim ndaj punëtorëve të transmetuesit publik.

B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?

Niveli i pavarësisë editoriale në sektorin jo-fitimprurës është shumë më i lartë krahasuar me sektorët e tjerë. Mediat në këtë sektor vazhdojnë të jenë financiarisht më të qëndrueshme për shkak se funksionojnë kryesisht nga donacionet, përfshirë Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), Çohun dhe Institutin e Kosovës për Drejtësi që janë të përqendruar në gazetarinë hulumtuese.

Ato financohen nga organizatat ndërkombëtare të mediave, qeveri të huaja, ambasada, Komisioni Evropian dhe institucione të tjera të BE-së.

Këto media mbulojnë çështje që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë, shpenzimet publike dhe korrupsionin. Pasi që këto media kanë më shumë qëndrueshmëri financiare, ato e kanë më të lehtë të raportojnë pa patur frikën nga ndonjë hakmarrje politike apo ekonomike. Mediat jo-fitimprurëse janë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës për media të shkruara dhe vizive, gjersa disa kanë kode të brendshme të sjelljes.

B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?

Në përgjithësi gazetarët kanë liri të mjaftueshme për të zgjedhur lajmet e ditës nëse nuk i përcaktohet ndryshe nga redaktori. Këta të fundit bëjnë përzgjedhjen se cili kënd i lajmit duhet të theksohet. Gazetarët e intervistuar theksojnë trendin e mbulimit të drejtpërdrejtë të konferencave, e sidomos atyre nga mediat online, përmes gazetarëve të cilët incizojnë me telefona të mençur dhe transmetojnë në llogarinë e tyre në Facebook dhe në portal.

Sipas anketës së bërë gjatë vitit të kaluar, gazetarët u pyetën për shumë faktorë që mund të ndikojnë në punën e tyre të përditshme. Ata deklaruan se redaktorët kanë më shumë ndikim (tepër, shumë apo deri diku me ndikim - 84%) në punën e tyre, ndërsa menaxherët (44%) dhe pronarët (42%) kanë më pak ndikim.

Në anën tjetër, politikanët në përgjithësi (14%) dhe zyrtarët e qeverisë (14%) kanë shumë më pak ndikim në punën e përditshme të gazetarëve, e në fund individët që punojnë në mjedisin e tyre të përditshëm.

Mbi censurën, gazetarët (30%) u shprehën se ka disi ndikim në punën e tyre, ndërsa 28 për qind e gazetarëve thanë se censura nuk ka ndikim.

*"Ka censurë në media që bëhet ndonjëherë me iniciativë të shefave, e ndonjëherë me autocensurë, që unë mendoj se është më e rrezikshmja dhe mendoj se është goxha e shpeshtë dhe kjo po e dëmton gazetarinë. Autocensura mund të vërehet kur ke takime me partitë për shkak të interesave të përbashkëta. Pastaj lidhja media me reklamën, dhe kjo i dëmton shumë gazetarinë, e sidomos mediat online."*⁴¹

41 Saranda Ramaj, gazetare, intervista e mbajtur më 18 maj 2017



C.1 Statistikat e Sigurisë dhe Pandëshkueshmërisë

Prej 1 janarit e deri më 30 shtator 2017, AGK-ja ka regjistruar 11 raste që përfshijnë kërcënime me jetë, sulm fizik, kërcënime verbale dhe dëmtim prone.

Më poshtë paraqesim tabelën me rastet kundër gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medialë.

Kërcënime kundër jetës dhe lëndime trupore të gazetarëve	Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve	Sulmet aktuale ndaj gazetarëve	Vrasjet e gazetarëve	Kërcënimet kundër mediave dhe organizatave mediale	Sulmet ndaj mediave dhe organizatave mediale	Total
5	5	1	0	0	0	11

Ndërsa, sipas raportit të policisë, prej janarit e deri më korrik 2017, ata kanë regjistruar 15 raste, kryesisht raste të kanosjes ndaj gazetarëve dhe një rast që nuk ka të bëjë me punën e gazetarit. Në vijim ju paraqesim rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve që kanë ndodhur që nga fillimi i këtij viti.

1. Mentor Shala, Ridvan Berisha, Prishtinë, rasti i ndodhur më 20.01.2017:

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka kundërshtuar fushatën linquese të subjektit politik Vetëvendosje ndaj drejtorit gjeneral të Radiotelevizionit të Kosovës Mentor Shala dhe kryeredaktorit Ridvan Berisha. Ky reagim ka ardhur pas disa paraqitjeve publike të anëtarëve të Vetëvendosjes të cilët linquan publikisht dhe për një kohë të gjatë udhëheqësitë e transmetuesit publik. AGK-ja ka kërkuar nga kjo parti politike të reflektonte pas disa gabimeve që ka bërë muajt e fundit duke akuzuar, linquar dhe kërcënuar gazetarë.

2. Sindikata e Pavarur e Radiotelevizionit të Kosovës, Prishtinë, 08.02.2017:

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka pranuar me shqetësim një postim në rrjetin social Facebook të drejtorit gjeneral të RTK-së, Mentor Shala. AGK-ja konsideron se gjuha e përdorur nga z.Shala paraqet ofendim dhe kërcënim për punëtorët e mediumit publik, duke përfshirë anëtarët tonë që punojnë në këtë medium. AGK-ja është njoftuar nga punëtorët e mediumit publik se ky reagim i z.Shala vjen pas takimeve të ndara që drejtuesit e Sindikatës së Pavarur të RTK-së kanë zhvilluar me kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe me të gjitha grupet parlamentare lidhur me draftimin e ligjit për RTK-në dhe gjendjen e përgjithshme në Transmetuesin Publik.

3. Arbana Xharra, Prishtinë, 23.02.2017:

Kryeredaktorja e së përditshmes Zëri Arbana Xharra është kërcënuar nëpërmjet Facebook-ut nga një individ i quajtur Ebu Duxhane, i cili i ka dërguar një foto Xharrës ku shihet një njeri pa kokë dhe lidhet me luftën në Siri. Duxhane po ashtu ka shkruajtur “Ta dish se ne do të të gjejmë” dhe “Ne e dimë se sa i do fëmijët e tu”. Policia e Kosovës është duke e hetuar rastin.

4. Fatmir Lama, Prishtinë, 28.02.2017:

Producenti në KTV Fatmir Lama është kërcënuar me jetë përmes një thirrjeje telefonike nga një i dyshuar

për shkak të një dokumentari me të cilin kërcënuesi nuk ishte i kënaqur. I dyshuari u prezantua me emër e mbiemër dhe kishte kërcënuar Lamën me jetë nëse nuk e largon ritransmetimin.

5. Vehbi Kajtazi, Prishtinë, 17.03.2017:

I dyshuari me qëllim ka dëmtuar veturën e gazetarit. Policia dhe prokuroria kanë intervenuar menjëherë. I dyshuari është mbajtur në paraburgim prej 48 orësh.

6. Arbana Xharra, Prishtinë, 10.04.2017:

Kryeredaktorja e së përditshmes Zëri Arbana Xharra ka raportuar në polici një kërcënim që i është bërë përmes grafitëve – shenjë kryqi me ngjyrë të kuqe – në murin afër derës së banesës dhe një tjetër te garazha e saj nga persona të panjohur. Ky kërcënim ndërlihet me punën e saj që raporton në fushën e radikalizmit dhe ekstremizmit Islam në vend.

7. Berat Buzhala, Prishtinë, 21.04.2017:

Berat Buzhala, drejtor i portalit gazetaexpress.com ka marrë kërcënim përmes llogarisë së Facebook-ut. Ai e ka raportuar rastin në polici. I dyshuari është arrestuar.

8. Salie Gajtani-Osmankaq, Prishtinë, 02/07/2017:

Gazetarja e së përditshmes Koha Ditore Salie Gajtani-Osmankaq është kërcënuar verbalisht nga një grup burrash kur ajo po tentonte të raportonte. Gazetarja ka shkuar për të parë për së afërmi se si po përgatiteshin disa banorë në një lagje të Prishtinës të largoheshin nga banesat nga të cilat shteti i ka urdhëruar të dalin pasi konsideroheshin si uzurpatorë. Banorët menjëherë iu vërsulen gazetarës duke e kërcënuar se nuk guxon të publikojë asnjë lajm. Gazetarja, e cila ishte së bashku me vozitësin Ilir Hamiti, u largua nga aty dhe u futën në makinën e tyre. Banorët bllokuan makinën që të qarkullojë dhe vazhduan me tone kërcënuese. Gazetarja Gajtani dhe vozitësi arrijnë të largohen nga aty. Më 26 shtator 2017, Policia e Kosovës informon AGK-në se ky rast është ende nën hetime.

9. Parim Olluri, Prishtinë, 16.08.2017:

Gazetari Parim Olluri u sulmua në orët e vona të natës së 16 gushtit nga tre persona të panjohur derisa ishte duke u kthyer në banesën e tij së bashku me bashkëshorten. Ajo humb vetëdijen nga shoku i përjetuar nga sulmi. Të dyve iu dha

ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës (QKUK). Më 26 shtator 2017, Policia e Kosovës informon AGK-në se ky rast është ende nën hetime.

10. Parim Olluri dhe Vehbi Kajtazi, Prishtinë, 11.09.2017:

Deputeti i Kuvendit të Kosovës Milaim Zeka ka kërcënuar publikisht dy gazetarët, Parim Olluri dhe Vehbi Kajtazi, duke i quajtur spiunë serbë që kanë për detyrë që të denigrojnë dhe poshtërojnë figurat kombëtare. Ish-gazetari Zeka tha se gazetarët marrin udhëzime nga agjencia sekrete e inteligjencës serbe për të shpërndarë të pavërteta për politikanët e Kosovës.

11. Vehbi Kajtazi, Prishtinë, 14.09.2017:

Kryeredaktori i gazetës Insajderi Vehbi Kajtazi ka njoftuar Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës se ka marrë një kërcënim me jetë. Kajtazi ka thënë se është kërcënuar nga deputeti Bekë Berisha, i cili sipas gazetarit ka shkuar në restorantin e një miku të tij duke ia lënë këtë porosi: “Tregoji atij shokut tënd se nëse edhe një herë ma përmend emrin në gazetë, të pret plumbi në ballë”. Më 26 shtator 2017, Policia e Kosovës informon AGK-në se ky rast është ende nën hetime.

C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?

Në përgjithësi, institucionet shtetërore dhe aktorët politikë nuk mbajnë përgjegjësi të mjaftueshme për mbrojtjen e gazetarëve. Raporti i AGK-së për vitin e kaluar ka nxjerrë disa rekomandime për institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, ku u kërkua që të jenë më efikase në trajtimin e rasteve të gazetarëve të rrezikuar nga kërcënimet apo sulmet.

Gjatë muajit mars 2017, përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës kanë pasur takime me nivele të larta të institucioneve shtetërore, ku janë diskutuar problemet e gazetarëve në raport me sistemin e drejtësisë si dhe është kërkuar rritja e efikasitetit për krijimin e një ambienti më të sigurt për gazetarët në Kosovë.

Një javë më vonë, përfaqësuesit e AGK-së u takuan edhe me drejtorin e përgjithshëm të policisë së Kosovës Shpend Maxhuni, ku u diskutua për thellim të bashkëpunimit për sigurinë e gazetarëve në vend. Drejtori i policisë u njoftua me raportin e vitit 2016 në lidhje me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve, e në veçanti u diskutua për rekomandimet e dala për policinë. AGK-ja kërkoi nga drejtori Maxhuni që Policia e Kosovës t'i trajtojë me prioritet rastet e sulmeve apo kanosjeve ndaj gazetarëve dhe për të njëjtat të bashkëpunojë me organet e drejtësisë.

Drejtori Maxhuni u zotua për një bashkëpunim të ndërsjellë që do të ndikonte pozitivisht në punën e policisë dhe mediave në vend. Në takim po ashtu u diskutua për transparencën e policisë në raport me mediat, ndërkohë që temë diskutimi po ashtu ishte edhe trajtimi nga ana e Policisë së Kosovës të kërcënimeve që vijnë përmes rrjeteve sociale.

Gjatë vitit 2016 ka pasur një debat të gjatë në publik pas publikimit të përgjimeve nga ana e portalit Insajderi, ku u shpërfaqen biseda telefonike të rrjedhura që përfshinin politikanët e nivelit të lartë. Protagonisti kryesor në këto përgjime ishte Adem Grabovci, kryetar i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i cili u shfaq në dhjetëra telefonata me bashkëpartiakët e tij duke kurdisur emërime të njerzve të afërt me partinë nëpër institucionet publike. Reagimet ishin të mëdha në publik ndërsa mediat vendore dhe ato ndërkombëtare kanë ripublikuan përgjimet dhe raportet që zbuluan abuzimin e fuqisë nga politikanët për interesa të ngushta të partisë.

Grabovci ka paditur portalin Insajderi.com për shkelje të privatësisë dhe kërkoi nga gjykata masë të përkohshme për të ndaluar publikimet e tjera. Gjykata Themelore në Prishtinë e ka refuzuar kërkesën e tij. Në një rast tjetër, kryeredaktori i gazetës Express Leonard Kërquki ka marrë një numër të madh të kërcënimeve me vdekje, kryesisht në rrjetet sociale, pas transmetimit të dy dokumentarëve që përshkruanin pasurinë e disa politikanëve kosovarë dhe krimet e luftës të kryera nga shqiptarët gjatë luftës më 1998-1999 në Kosovë.

C.3 A i trajton në mënyrë të efektshme sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?

Në përgjithësi, sistemi i drejtësisë nuk i trajton me efektshmëri kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve. Ende asnjë prej nëntë rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve të regjistruara këtë vit nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës nuk ka arritur të gjykohet në gjykatë.

Një rast i vitit të kaluar është gjykuar këtë vit, dhe i pandehuri është dënua me gjobë për shkak se ka ngacmuar kryeredaktoren Mimoza Koprani Muçaj dhe gazetarin Ridvan Hamza. Ngacmimi ka ndodhur më 27 shtator 2016, kur i pandehuri i ka shkruar televizionit Koha Vision përmes Facebook-ut sepse nuk ishte i kënaqur me një lajm që kishte të bënte me vëllain e tij. I pandehuri është dënua me 300 euro gjobë.

Në një rast tjetër, AGK-ja ka kuptuar nga Rifat Bllata, gjykatës mbikqyrës në gjykatën themelore të Mitrovicës, dega në Vushtrri, se rasti i një gazetari të sulmuar fizikisht nuk është duke u trajtuar për shkak të numrit të madh të rasteve. Rasti ka të bëjë me gazetarin Gazmend Morina, i cili u sulmua më 26 janar 2016 nga asambleisti i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës për shkak të shkrimeve të tij.

“Lënda Penale P.nr. 349/16 me dt. 26.07.2016, është pranuar në këtë gjykatë dhe e njëjta lëndë për të cilën po bëhet fjalë është ndarë në punë gjyqtarit Hanefi Jasharit dhe atë sipas evidencës nga shërbimi i shkrimoreve të lëndëve penale nuk janë ndërmarrur veprime për caktimin e kësaj lënde për shkak të vëllimit të madh të lëndëve në punë.”⁴²

Për këtë rast, AGK-ja ka takuar kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nehat Idrizi, ku është diskutuar për trajtimin me prioritet të lëndëve gjyqësore në të cilat janë të përfshira mediat dhe gazetarët. Përveç kësaj, u kërkua ndikimi në intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet gjykatave me përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, në mënyrë që të krijohet një databazë e të gjitha rasteve të cilat janë shqyrtuar apo presin që të shqyrtohen nga ana e gjykatave.

Kryesuesi Idrizi u zotua se do të kërkojë efektivitet më të madh nga ana e gjykatave për zgjidhjen e

këtyre lëndëve gjyqësore. Në fund, kryetari i bordit të AGK-së dhe kryesuesi i KGJK-së u dakorduan se trajtimi me prioritet dhe zgjidhja e këtyre lëndëve do të ndikonte në krijimin e një ambienti më të sigurtë për punën e përditshme të gazetarëve, njëkohësisht do të kishte ndikim edhe në rritjen e profesionalizimit në media.

Përkundër faktit që vitin e kaluar prokuroria themelore e Prishtinës nuk ishte në gjendje të ofrojë të dhëna për rastet e përgjithshme që ndërlidhen me gazetarët, këtë vit kjo prokurori ka ofruar të dhëna. Kjo vjen për shkak të marrëveshjes së arritur ndërmjet AGK-së dhe zyres së Kryeprokurorit të Shtetit.

Më 21 qershor 2017, në një takim të përbashkët ndërmjet AGK-së dhe zyres së Kryeprokurorit të Shtetit, janë paraqitur të gjitha rastet që kishin të bënin me gazetarët e kërcënuar apo të sulmuar që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999. Sipas zyres së kryeprokurorit, në sistemin e drejtësisë në Kosovë janë regjistruar gjithsej 120 raste të sulmeve, kanosjeve dhe rasteve të tjera ndaj gazetarëve. Statistikat treguan se në Prishtinë janë 90 raste, në Pejë 4 raste, në Mitrovicë 16 raste, në Gjiilan 9 raste, në Ferizaj 1 rast, ndërsa në Prizren nuk ka pasur asnjë rast të ngritjes së ndonjë aktakuzë.

Sa i takon prokurorisë në Prishtinë, prej 90 rasteve prokuroria ka ngritur 22 aktakuzat dhe në anën tjetër ata informojnë se janë 7 aktgjykime nga gjykatat. Po ashtu, prokuroria ka thënë se është duke grumbulluar informacione për 44 raste.

Gjykata Themelore në Prishtinë thekson se nga 22 aktakuzat e ngritura nga prokuroria, 12 raste priten që të fillojnë me seanca gjyqësore, gjersa katër lëndë janë përfunduar (dy janë me urdhër ndëshkimi) ndërsa për gjashtë lëndë të tjera gjykata nuk ishte në gjendje që të raportojë për statusin e tyre. Rastet e sipër përmendura janë të viteve prej 2014

Gjyqtarja Makifete Saliuka kishte vendosur në favor të një personi i cili punonte në një shtypshkronjë, pronë e njëjtë e gazetës, dhe i cili kishte pësuar aksident në vendin e punës duke humbur njërin dorë. Që nga ai vendim, gazeta kishte shkruar artikuj të shumtë kundër gjyqtarës, duke shkelur vazhdimisht kodin e etikës.⁴³ Një gazetare komentoi:

⁴² Rifat Bllata, email autorit më 19 qershor, 2017

⁴³ E qasshme në: <http://presscouncil-ks.org/vendim-i-kes-hillit-te-mediave-te-shkruara-te-kosoves-ndaj-ankeses-se-makifete-saliukagjykatese-e-gjykatës-komunale-te-prishtinës-kunder-gazetes-kosova-sot/>

“Prej kontakteve që unë kam pas me gjyqtarë, por edhe gjatë seancave që unë i kam ndjek si gazetarë, ata/ato kanë shprehur frikën e tyre për t’u marrë me çështje të gazetarëve. Edhe ne gazetarët duhet të jemi më të moralshëm.”⁴⁴

Një gazetar tjetër tha se gjykatat janë pak më të hapura ndaj mediave në krahasim me vitet e kaluara, por kjo nuk mjafton. Kritika u zgjerua kur në fund të 2016-ës, dy gjyqtarë në dy raste të ndara të proflit të lartë për korrupsion, i kanë mbyllur seancat gjyqësore për mediat dhe publikun.

Rasti i parë ka të bëjë me ish kryetarin e Gjykatës së Apelit i dyshuar për korrupsion dhe gjykatësi dha arsyetimin se mbyllja e seancave po bëhet për shkak të mbrojtjes së jetës personale së të akuzuarve, të dëmtuarve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Rasti i dytë ka të bëjë po ashtu me korrupsion, ku një numër i madh i mjekëve dyshohen për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje të rryshfetit. Në këtë rast është i përfshirë edhe ish-ministri i shëndetësisë dhe sekretari i përhershëm i kësaj ministrie.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka reaguar për mbylljen e këtyre seancave duke thënë se disa seanca mund të jenë të mbyllura, por jo i gjithë procesi gjyqësor. AGK-ja i ka shkruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës për këtë çështje, por edhe ky institucion nuk ka dhënë ndonjë mendim sa i përket mbylljes së proceseve gjyqësore.

Në gusht 2017 është bërë rizgjedhja e kryetarit të Gjykatës Supreme Enver Peci, pas anulimit të zgjedhjes së parë në mars nga Gjykata Kushtetuese, e cila theksoi se procesi i votimit nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme për një proces transparent. Valdete Daka, njëra nga konkurreset për këtë post, ishte ankuar në Gjykatë Kushtetuese për shkak të procesit të parregullt të votimit. Kushtetuesja vendosi për përsëritje të konkursit.

Para shpalljes së konkursit të dytë, zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë me partnerët e tjerë dhe së bashku me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) punuan për të avancuar procedurën e përzgjedhjes dhe kështu të përmirësojnë rregulloren relevante të KGJK-së. Megjithatë, në fund zyra e BE-së reagoi për procesin e përzgjedhjes së kryetarit, duke i vëzhguar dy proceset, dhe theksoi se janë bërë lëshime në përzgjedhje duke mos pasur diskutim thelbësor për përshtatshmërinë e kandidatëve për këto pozita.⁴⁵

Në letrën e tyre, zyra e BE-së theksoi se drejtësia

në Kosovë duhet të jetë e pavarur, transparente, e përgjegjshme dhe e lirë nga ndërhyrjet e politikës. Në mars të këtij viti është zgjedhur po ashtu kryetari i Gjykatës së Apelit Hasan Shala.

Më 8 mars 2017, përfaqësuesit e AGK-së kanë pasur takim me Kryeprokurorin e Shtetit Aleksandër Lumezi, ku janë diskutuar rekomandimet e dala për prokurorinë e vendit si një segment i rëndësishëm për trajtimin e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Kryeprokurori Lumezi nxorri një vendim me të cilin do të caktohet një prokuror nga Zyra e tij si koordinator për rastet e kanosjeve apo veprave të tjera penale që kryhen ndaj gazetarëve në lidhje me punën e tyre.

Po ashtu, vendimi obligon kryeprokurorët e Prokurorive Themelore në qytetet e tjera që të caktojnë nga një prokuror, të cilët do të merren edhe me rastet e raportuara ku gazetarët paraqiten si të dëmtuar. Kryeprokurori Lumezi tha se prokurorët do t’i trajtojnë rastet e tilla me prioritet dhe prokurorin e ngarkuar si koordinator do ta mbajnë të informuar për të gjitha veprimet e marra në procedura.

Po ashtu, ky vendim ka paraparë që prokurori i caktuar si koordinator të mbajë një databazë të posaçme në lidhje me këto raste dhe me vendim obligohet që në baza të rregullta mujore të informojë Kryeprokurorin e Shtetit për të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë drejtim. Kjo databazë tashmë është në funksion dhe është paraqitur në takimet e tjera me prokurorin/koordinatorin. Po ashtu, AGK-ja ka kërkuar nga zyra e Prokurorit të Shtetit që t’i përfshijë të gjitha rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në raportin e tyre vjetor.

Gjykata Themelore në Prishtinë përfshin pothuajse shumicën e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Kryetarja e Gjykatës Themelore Afërdita Bytyçi po ashtu ka mirëpritur rekomandimet e dala nga raporti i AGK-së dhe tha se do të kërkojë nga gjyqtarët që të punojnë më shpejt në rastet e gazetarëve që janë viktimë të dhunës, si në lëminë civile po ashtu edhe penale. Gjykata në bashkëpunim me AGK-në do të identifikojnë të gjitha rastet e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medialë që janë si viktimë e që presin drejtësinë të thotë fjalën e fundit.

⁴⁴ Anonime, gazetarë, intervista e mbajtur më 24 maj 2017

⁴⁵ I qasshëm në: https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/31361/statement-process-selection-supreme-court-and-court-appeals-presidents_en



Lista e personave të intervistuar

Emri	Pozita, Organizata	Data e intervistës
Saranda Ramaj	Gazetare në Koha Ditore	18 maj 2017
Përparim Isufi	Gazetar në BIRN	19 maj 2017
Durim Abdullahu	Gazetar në KTV	23 maj 2017
(Anonim)	Gazetar në televizion	24 maj 2017
Arsim Rashiti	Gazetar në Ekonomia Online	24 maj 2017
(Anonim)	Gazetar	25 maj 2017
Flutura Kusari	Eksperte e ligjit për media	26 qershor 2017
Imer Mushkolaj	Kryetar i KMSHK-së	19 qershor 2017



Referenca dhe burime

Libra, kapituj, artikuj:

<http://www.5rb.com/case/cumpana-and-mazare-v-romania/>

Platforma regjionale e Ballkanit Perëndimor për avokim të lirisë mediave dhe sigurisë së gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, f.18, qasur më 9 gusht 2017: <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raporti-i-plot%C3%AB.pdf>

KPM, Raport monitorimi i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme 2017, qasur më 11 gusht 2017: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1499342536.8299.pdf>

European Union Election Observation Mission, Preliminary statement, 13 qershor 2017, f.7, qasur më 20 gusht 2017: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eu_eom_kosovo_2017_ps_en.pdf

E qasshme në: <http://presscouncil-ks.org/vendim-i-keshillit-te-mediave-te-shkruara-te-kosoves-ndaj-ankeses-se-makifete-saliukagjykatese-e-gjykates-komunale-te-prishtines-kunder-gazetes-kosova-sot/>

Dokumentet ligjore, politika:

Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2007/13

Ligji Nr. 05/L -047 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Rregullore MF - NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve

Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, neni 18

Kushtetuta e Kosovës, neni 42

Ligji Nr. 04/L-044 për komisionin e pavarur për media, neni 5

Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Ligji Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike

Artikuj të medieje:

Indeksonline, 17 janar 2015, qasur më 11 gusht 2017: <http://telegrafi.com/mustafa-akuzon-rtk-ne-po-sillet-si-medium-partiak/>

Insajderi, “VV zbulon lidhjen mes zëvendës drejtorit të antiterrorizmit dhe PDK-së”, 30 gusht 2016, qasur më 11 gusht 2017: <http://www.insajderi.com/vv-akuzon-zevendesdrejtorin-e-antiterrorizmit-per-lidhjet-pdk-ne/>

Die Morina, “Anëtarët e Vetëvendosjes të arrestuar për shpërthimin në Kuvendin e Kosovës”, 30 gusht 2016, qasur më 11 gusht 2017: <http://www.balkaninsight.com/en/article/vetevendosje-members-arrested-for-bomb-in-kosovo-assembly-08-30-2016>

Mentor Gjergjaj, “Shteti ua pezulloi sërish punën 16 organizatave që dyshohen për lidhje me grupe radikale (Dokument) [State cancelled again the work of 16 organisations suspected for connections with radical groups (Document)],

Gazeta Express, 9 janar, 2017. Qasur më 1 gusht 2017: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/shteti-ua-pezulloi-serish-punen-16-organizatave-qe-dyshohen-per-lidhje-me-grupe-radikale-dokument-304696/?archive=1>

Koha Ditore, “SPRTPK reagon për punësime të pakontrolluara në RTK”, 20 korrik 2017. Qasur më 15 gusht 2017: <http://www.koha.net/arberi/32862/sprtpk-se-reagon-per-punesime-te-pakontrolluara-ne-rtk/>

Koha Ditore, “SPRTPK akuzon drejtuesit e RTK-së për manipulim financiar”, 13 mars 2017. Qasur më 15 gusht 2017: <http://www.koha.net/arberi/5393/sprtpk-akuzon-drejtuesit-e-rtk-se-per-manipulim-financiar/>

